

VENDIM
Nr.1288, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët “Gjuhë-letërsi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët “Histori-gjeografi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën histori-gjeografi.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha